

DATAMARRJES 05.05.2017  
PROT 708

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

*Ndërmjet*

**FAKULTETIT TË EKONOMISË**

**UNIVERSITETI I TIRANËS**

*dhe*

**INSTITUTIT TE STATISTIKAVE (INSTAT)**

TIRANË

më datë 02/05/2017

**FAKULTETI I EKONOMISË** (këtej e tutje "FEUT"), përfaqësuar nga Z. Dhori Kule, Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, veprimtaria e të cilit mbështetet në Ligjin Nr. 8461, datë 25.02.1999 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë";

dhe

**INSTITUTI I STATISTIKAVE** (këtej e tutje "INSTAT"), përfaqësuar nga Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtor i Përgjithshëm, është institucioni publik qendror, veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 " Për statistikat zyrtare" i ndryshuar;

Duke synuar zhvillimin e bashkëpunimit dhe partneritetit dypalësh në lidhje me njohjen, përmirësimin e sistemit statistikor në Shqipëri, transmetim të dijeve mbi statistikat përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, veprimtarive njohëse e promovuese dhe shërbimeve nga institucionet e arsimit të lartë;

### **BIEN DAKORT:**

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

### **NENI 1**

#### **Parimet dhe vlerat e bashkëpunimit**

1. Kjo marrëveshje synon sigurimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve nënshkruese (me poshtë, "palët") lidhur me:
  - a) përmirësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së programeve të studimit me koncepte dhe analiza të hartimit, zbatimit e monitorimit të sistemit statistikor në Shqipëri.
  - b) Planifikimin e organizimin e veprimtarive të përbashkëta njohëse, promovuese e shkencore për të mundësuar njohjen e kuptimin sa më të mirë të statistikave duke kontribuar në edukimin e publikut.
2. Dy institucionet angazhohen të punojnë së bashku në përputhje me kërkesat ligjore dhe frymën e mirëkuptimit, për të realizuar interesat reciproke që synon kjo marrëveshje.

### **NENI 2**

#### **Fushat e bashkëpunimit**

### **NENI 3**

#### **Pronësia Intelektuale**

Kur si rezultat i bashkëveprimeve të kryera në përputhje me këtë Marrëveshje, realizohen produkte që janë objekt i së drejtës mbi pronësinë intelektuale, ato do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

### **NENI 4**

#### **Komunikimi**

Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm në të gjitha nivelet. Me qëllim përmbushjen e objektivave të kësaj marrëveshjeje, secila palë do të caktojë një person si koordinues për komunikimin midis tyre dhe përcjelljen e problematikave sipas rastit.

### **NENI 5**

#### **Kufizimet e marrëveshjes**

1. Të dy palët bien dakord që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në varësi të përparësive, planifikimit paraprak, burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.
2. Për çdo veprimtari tjetër, që përputhet me frymën e kësaj marrëveshjeje, palët kanë të drejtë të konkludojnë mbi mënyrën e realizimit të bashkëpunimit.
3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve.
4. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do të rregullojnë këto raporte me marrëveshje të veçanta financiare të cilat do të jenë pjesë integrale e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
5. Palët bien dakort që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

### **NENI 6**

#### **Ndryshimi, amendimi dhe revokimi i Marrëveshjes**

Çdo nen i kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

## NENI 7

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshje, do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim mes palëve.

## NENI 8


### Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të palëve, dhe do t'i shtrijë efektet për një periudhë kohe të pakufizuar. Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje dhe secila nga palët mban një kopje në origjinal.

nënshkruar sot , më datë 2 / 5 /2017, në Tiranë

Për FAKULTETIN E EKONOMISË

Dhori KULE



Për INSTAT

Delina IBRAHIMAJ

Drejtor i Përgjithshëm

